AUSTRIAN AUDIO

Kufje profesionale Over-Ear Hi-X25BT me Bluetooth®

Manuali i përdorimit

Hyrje dhe udhëzime sigurie

Kufjet Hi-X25BT kanë nevojë për një pajisje me **Bluetooth®** (p.sh., kompjuter, celular etj.) që të përdoren në modalitetin me valë. Duke përdorur kabllon USB-C® në USB-C® të dhënë, mund të dëgjoni gjithashtu në modalitetin e audios dixhitale dhe duke përdorur kabllon xhek, mund të dëgjoni në modalitetin e audios analoge.

Ju lutem lexoni dhe ndiqni udhëzimet në këtë manual para se ta përdorni këtë produkt.

- Ju lutem mos e përdorni këtë produkt përveçse për qëllimin për të cilin është menduar. Austrian Audio nuk mund të pranojë asnjë përgjegjësi për dëmtimet që vijnë nga trajtimi i papërshtatshëm ose keqpërdorimi.
- Dëgjimi i pajisjeve personale stereo me volum maksimal për periudha të gjata mund të dëmtojë dëgjimin e përdoruesit.
- Mos e përdorni nëse produkti ka defekt.
- Mbajeni dhe përdoreni gjithnjë produktin në një vend të thatë e të sigurt.
- Produkti përmban një bateri me polimere litiumi. Mos e ekspozoni në nxehtësi të lartë (mos e lini në makinë kur është e parkuar në diell, mos e hidhni në zjarr dhe mos e futni në mikrovalë).
- Mos e përdorni jashtë temperaturave të lejueshme të punimit: 0 °C deri në 45 °C (32 °F deri në 113 °F).
- Mos e karikoni produktin nëse është tepër i nxehtë ose tepër i ftohtë. Lëreni të ftohet ose të ngrohet deri në rreth 20 °C deri në 30 °C (68 °F deri në 86 °F) para se ta karikoni. Mos e lini produktin të pambikëqyrur kur e keni të lidhur me një burim energjie.
- Mos e përdorni këtë produkt në ambient me lagështi.
- Mos e rrëzoni.
- Drajverat e brendshëm High-Excursion përmbajnë magnete.
- Ju lutem mbajeni këtë produkt larg nga fëmijët e vegjël dhe nga personat që nuk janë në gjendje të përdorin pajisjet profesionale audio.
- Nëse e keni të nevojshme ta pastroni produktin, bëjeni këtë vetëm me një leckë të butë e të thatë.
- Ju lutem mos përdorni asnjë aksesor të palëve të treta, përveç nëse tregohet ndryshe.
- Mos e çmontoni produktin pasi në të nuk ka pjesë që mund të riparohen nga përdoruesi.
- Mos e hiqni ngjitësen.

Faleminderit që lexoni udhëzimet dhe faleminderit shumë që i besoni Austrian Audio.

Përdorimi i Hi-X25BT:

Ndezja/fikja



Shtypni butonin on/off në kupën e djathtë për 2 sekonda derisa Hi-X258Bt t'ju urojë mirëseardhje me një "Power On" miqësore dhe drita LED blu të fillojë të pulsojë. Nëse ka ende një lidhje aktive, ato do të lidhen automatikisht me pajisjen me të cilën ishin lidhur më parë dhe do ta konfirmojnë këtë duke thënë "Connected" dhe drita LED do të qëndrojë ndezur ngjyrë blu.

Për t'i fikur kufjet, shtypni butonin on/off për 3 sekonda derisa Hi-X25BT të fiket duke thënë “Power Off” dhe drita LED blu të fiket.

Lidhja me Bluetooth®



Për të bërë një lidhje (të re), kufjet duhet të jenë të fikura. Tani shtypni butonin on/off dhe mbajeni shtypur për 5 sekonda. Kufjet do të ndizen dhe do të kalojnë automatikisht në modalitetin e lidhjes, e konfirmuar me fjalën "Pairing" dhe me dritën LED blu që pulson shpejt ngjyrë blu.

Shënim: Nëse po i ndizni kufjet për herë të parë, ato do të kalojnë automatikisht në modalitetin e çiftimit.

Shënim: Nëse kufjet nuk mund të lidhen dot me pajisjen tuaj (p.sh. ngaqë Bluetooth® është çaktivizuar në pajisjen tuaj), kufjet do të fiken automatikisht pas njëfarë kohe.

Karikimi dhe dëgjimi i audios në modalitetin e audios dixhitale



Ju lutem përdorni kabllon USB të dhënë për t'i karikuar kufjet. Lidhja Bluetooth® do të mbetet, dhe ju mund të vazhdoni të përdorni Hi-X25BT ndërsa i karikoni me kabllon USB.

Nëse Hi-X25BT janë të lidhura, për shembull, me një laptop, mund të vazhdoni të dëgjoni muzikë nëpërmjet kabllos USB të lidhur ndërkohë që kufjet janë duke u karikuar. Për t'u treguar kufjeve Hi-X25BT se doni të kaloni nga modaliteti Bluetooth® te modaliteti i audios dixhitale, shtypni për pak butonin on/off.

Shënim: Ju lutem mbani parasysh se mikrofoni nuk është i disponueshëm në modalitetin e audios dixhitale.

Nëse doni të ktheheni nga modaliteti i audios dixhitale te modaliteti i Bluetooth®, thjesht shtypni përsëri butonin on/off për pak.

Dëgjimi në modalitetin e audios analoge



Modaliteti analog funksionon pa përdorur baterinë, ja pse Hi-X25BT fiket automatikisht kur lidhni kabllon e xhekut analog. Tani ju duhet një pajisje (p.sh. një smartfon) që ka dalje xheku. Për ta lidhur Hi-X25BT me pajisje audio profesionale. ju duhet gjithashtu një adaptor 3.5 në 6.3 mm (1/8” në 1/4”), i cili është përfshirë.
Shënim: Kur jeni në modalitetin e audios analoge, funksionet e kontrollit me prekje në kupën e djathtë çaktivizohen. Mund të vini re ndryshime të mëdha në volum midis modalitetit Bluetooth® dhe atij të audios analoge.

Funksionet e kontrolleve me prekje

Hi-X25BT është i pajisur me kontrolle kapacitive në kupën e djathtë për të kontrolluar shumicën e funksioneve me Bluetooth®.



- Për ta rritur volumin, lëvizni lart shinën.
- Nëse e lini gishtin mbi sensor pasi keni lëvizur lart, Hi-X25BT do të vazhdojnë ta rritin volumin derisa ta lëshoni shinën ose derisa volumi të ketë arritur në maksimum.
- Për ta ulur volumin, lëvizni poshtë shinën.
- Nëse e lini gishtin mbi sensor pasi keni lëvizur poshtë, Hi-258BT do të vazhdojnë ta ulin volumin derisa ta lëshoni shinën ose derisa volumi të ketë arritur në minimum.



- Nëse doni të hapni asistentin me zë (nëse ka dhe nëse është i aktivizuar te burimi i Bluetooth®), vendosni njëkohësisht disa gishta mbi padin e kontrollit për më shumë se 3 sekonda.

Kur dëgjoni muzikë, është e mundur që:



- të filloni ose të ndaloni këngën me një shtypje të vetme te zona kapacitive.
- Kaloni te kënga tjetër duke shtypur dy herë.
- Kthehuni te kënga e mëparshme duke shtypur tre herë.

Nëse po ju marrin në telefon ose filloni të merrni në telefon dikë, kufjet Hi-X25BT do të kalojnë automatikisht te kontrolli i telefonit:

- Tani mund t'i përgjigjeni telefonatës ose mund ta mbyllni atë me një shtypje të vetme.
- Gjithashtu mund ta refuzoni një telefonatë duke shtypur dy herë.

Shënim: Nëse keni probleme me përdorimin e kontrolleve me prekje, ju lutem përpiquni të prekni me majën e gishtit ose ta vendosni gishtin më rrafshët në kupë. Gjithashtu do të gëzoni dobitë e kontrolleve kapacitive.

<u>Transporti i Hi-X25BT</u>



Kufjet Hi-X25BT janë të pajisura me 2 opsione të kursimit të hapësirës për transport:

Mund t'i ktheni kupat ose në drejtimin poshtë, që të qëndrojnë rrafshët – ideale për t'i transportuar kufjet, për shembull, në çantën e laptopit. Ose mund t'i palosni kupat drejt harkut të kokës që të marrin përmasa më kompakte (p.sh. për t'i futur në çantë dore ose shpine). Për transport, rekomandojmë që ta shkëputni kabllon dhe të përdorni çantën e dhënë për të mbrojtur sipërfaqen e kufjeve.

Si të ndërroni vatat e veshëve

Duke përdorur kitin e ndërrimit të vatave Hi-XBCUK (shiten veçmas) mund t'i ndërroni vetë me lehtësi vatat e Hi-X25BT.

Shënim: Vatat e veshëve janë të montuara me vida – ju lutem mos i tërhiqni vatat pa liruar vidat dhe ndiqni udhëzimet e mëposhtme.

1. Filloni duke nxjerrë shtrojat e sfungjerit si në anën e majtë, ashtu edhe në të djathtë. Pickojini me dy gishta që t'i nxirrni me lehtësi.



2. Përdorni një kaçavidë Torx® T6 për të liruar katër vidat në pllakën e brendshme. Nuk është e nevojshme që t'i zhvidhosni vidat komplet.



3. Tani mund të tërhiqni me kujdes vatat e veshëve dhe të montoni të rejat. Ju lutem sigurohuni që buzët e vatave të mbulohen komplet nga pllaka e brendshme.



4. Shtrëngoni vidat dhe shtyjeni me kujdes pllakën e brendshme në drejtim poshtë për t'i fiksuar vatat në vend. Më pas vendosni shtrojet e reja prej sfungjeri.



Zgjidhja e problemeve:

Kufjet Hi-X25BT lidhen gjithnjë me burimin e gabuar të Bluetooth®:

➔ Rekomandojmë që ta fshini listën e pajisjeve të lidhura. Shtypni butonin on/off për më shumë se 10 sekonda në kufje ndërkohë që janë të fikura. Më pas vendosni lidhjen e Bluetooth® te burimi juaj i preferuar përsëri.

Drita LED blu po pulson, por kufjet e mia nuk lidhen:

➔ Rekomandojmë që të filloni përsëri lidhjen e Bluetooth® nëpërmjet "Çiftimi". Nëse kjo nuk punon, ju lutem fshini listën e pajisjeve të lidhura siç tregohet më sipër dhe bëni lidhjen përsëri. Gjithashtu, burimi i Bluetooth® (smartfon, laptop etj.) mund të tregojë vetëm një numër të kufizuar të lidhjeve me Bluetooth®. Nëse është e nevojshme, fshini edhe listën te burimi i Bluetooth®. Për më shumë hollësi, ju lutem shikoni udhëzimet/manualin e pajisjes.

Jam lidhur me kabllo, por nuk bëj dot telefonata:

➔ Mikrofoni i brendshëm funksionon vetëm në modalitetin e Bluetooth®.

Dua të hyj në një konferencë telefonike me Bluetooth®, por askush nuk më dëgjon (ose unë nuk i dëgjoj dot pjesëmarrësit e tjerë):

➔ Në varësi të softuerit që përdoret, ndonjëherë burimi i audios në kompjuter nuk ndizet automatikisht. Zakonisht, mund t'i gjeni cilësimet e mikrofonit me simbolin e mikrofonit te softueri i konferencës. Ju lutem zgjidhni "Hi-X25BT" për mikrofon dhe altoparlant. Nëse softueri ka më shumë se një opsion profili, ju lutem zgjidhni "HFP" ose "HSP" por jo "A2DP" për konferencat.

Kufjet e mia Hi-X25BT nuk reagojnë ndaj asgjëje:

➔ Sigurohuni që kufjet janë karikuar mjaftueshëm. Tani bëni një reset të harduerit: Futni një objekt të hollë (p.sh. një kapëse letrash të drejtuar) në vrimën e vogël në anën e sipërme të kupës së djathtë të kufjeve dhe shtypni butonin poshtë. Kufjet Hi-X25BT do të rindizen (lidhjet tuaja të ruajtura nuk do të ndryshojnë).



Kufjet e mia Hi-X25BT pulsojnë shpejt pa pushim:

- ➔ Kufjet tregojnë se janë në pritje për të bërë një lidhje me Bluetooth® për herë të parë. Vendoseni burimin e Bluetooth® në modalitetin e çiftimit për të krijuar një lidhje.

Kufjet e mia thonë Hi-X25BT "Battery low" në intervale të rregullta:

- ➔ Bateria e kufjeve po bie: ju lutem karikojeni nëpërmjet portës USB.

Ndonjëherë, kufjet e mia Hi-X25BT nuk reagojnë aspak ose nuk reagojnë siç duhet ndaj kontrolleve kapacitive:

- ➔ Të gjitha kontrollet funksionojnë vetëm në modalitetin e Bluetooth®. Në modalitetin e USB, disa funksione mund të mos
  punojnë, disa jo, në varësi të pajisjes burim – kufjet tuaja Hi-X25BT nuk kanë ndikim te kjo.

- ➔ Ju lutem mos i përdorni kufjet Hi-X25BT me duar të lagura.

- ➔ Ju lutem pastroni sipërfaqen e sensorit nga ndotjet e mundshme ose nga pikat e ujit.

Kufjet e mia Hi-X25BT nuk punojnë në modalitetin pasiv:

- ➔ Për t'u treguar kufjeve Hi-X25BT se është koha që të luajnë në modalitetin pasiv, është e nevojshme që t'i siguroni pak energji shtesë kabllos xhek. Zakonisht, tensioni i mbetur i baterisë është i mjaftueshëm edhe pse nuk mjafton për të luajtur në modalitetin e Bluetooth®. Ju lutem karikoni kufjet për kohë më të shkurtër (ose më të gjatë).

Kufjet e mia Hi-X25BT nuk luajnë muzikë nëpërmjet kabllos USB:

- ➔ Ju lutem sigurohuni që kufjet nuk janë në modalitetin e Bluetooth®. Shtypni për pak butonin on/off për të kaluar në modalitetin e USB.

Kufjet e mia Hi-X25B nuk luajnë muzikë nëpërmjet Bluetooth®:

- ➔ Ju lutem sigurohuni që kufjet nuk janë në modalitetin e USB. Shtypni për pak butonin on/off për të kaluar te modaliteti i Bluetooth®.

- ➔ Ju lutem sigurohuni që funksioni i Bluetooth® në pajisjen tuaj është i aktivizuar. Në varësi të sistemit operativ, funksioni i luajtjes mund të ndalohet nga bashkëveprimet (p.sh. pranimi/refuzimi i një telefonate).

Kam lidhur kufjet e mia Hi-X25BT me burimin nëpërmjet kabllos USB; kjo gjë vërtetohet dhe tregohet nga pajisja burim por muzika nuk luhet:

- ➔ Ju lutem ndizini kufjet qëllimisht.

Është në përputhje me IEC 62368-1:2018 për pajisjet portative të audios.

Kur produkti arrin në fund të jetës së tij, shkëputeni kasën, pjesët elektronike dhe kabllot dhe hidhini të gjithë komponentët në përputhje me rregullat vendëse për hedhjen e mbetjeve!

Këtu, Austrian Audio GmbH deklaron se pajisja Hi-X25BT me valë radio është në përputhje me direktivën 2014/53/EU. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE mund të gjendet në adresën e mëposhtme të internetit: https://austrian.audio

Informacion ligjor për Kinën (针对中国的法律信息):

部件名称	有害物质					
	铅 (Pb)	汞 (Hg)	镉 (Cd)	六价铬 (Cr(VI))	多溴联苯 (PBB)	多溴二苯醚 (PBDE)
头戴式耳机	X	O	O	O	O	O
电缆	X	O	O	O	O	O
本表格依据 SJ/T 11364 的规定编制。						
O： 表示该有害物质在该部件所有均质材料中的含量均在 GB/T 26572 规定的限量要求以下。						
X： 表示该有害物质至少在该部件的某一均质材料中的含量超出 GB/T 26572 规定的限量要求						

Informacion ligjor për Kaliforninë (SHBA):

PARALAJMËRIM: Ky produkt mund t'ju ekspozojë ndaj lëndëve kimike, si plumbi, për të cilin Shteti i Kalifornisë është i mendimit se shkakton kancer dhe defekte në lindje ose dëmtime të tjera në sistemin riprodhues.
Për më shumë informacion, vizitoni: www.P65Warnings.ca.gov.

Copyright Austrian Audio 2021.

All rights reserved

Austrian Audio GmbH
Eitnergasse 15
1230 Vienna, Austria

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara të zotëruara nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga Austrian Audio GmbH bëhet me licencë. USB Type-C® dhe USB-C® janë marka tregtare të regjistruara të USB Implementers Forum. Torx® është një markë tregtare e regjistruar e Acument Intellectual Properties, LLC në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Hi-X25_Manual_A_EN-27.07.2021